



Retina Risk - Një aplikacion i ri për zbulimin e retinopatisë

Ky aplikacioni për zbulimin e riskut të retinopatisë përbën një mënyrë unike dhe revolucionare që u mundëson personave me diabet që të monitorojnë rrezikun e tyre individual të shfaqjes së retinopatisë diabetike, që është një nga shkaqet më të shpeshta të humbjes së shikimit tek diabetikët në mbarë botën. Ky aplikacion është krijuar nga një kompani me qendër në Islandë, e themeluar nga akademikë dhe ofrues të kujdesit shëndetësor me mbi 30 vjet eksperiencë në trajtimin e personave me retinopati diabetike dhe trajtimin e diabetit.

Sëmundshmëria nga diabeti, në nivel global, është trefishuar që nga viti 2000 me rreth 430 milionë persona dhe pritet të tejkalojë numrin 600 milionë deri në vitin 2045. Dy të tretat e personave me diabet zhvillojnë retinopati diabetike dhe një e treta zhvillojnë retinopati diabetike kërcënuese për shikimin gjatë njëzet vjetëve. Këta pacientë kanë rrezikshmëri të lartë të dëmtimit të shikimit ose edhe humbjes së shikimit nëse nuk diagnostikohen dhe trajtohen në kohën e duhur.

Kontrolli sistematik i syve dhe trajtimet parandaluese ndikojnë pozitivisht në reduktimin e ndjeshëm të humbjes së shikimit shkaktuar nga diabeti. Aplikacioni Retina Risk ndihmon në zbulimin e rrezikut të prekjes nga kjo sëmundje dhe është klinikisht i vlefshëm. Ky aplikacion ndihmon personat me diabet të vlerësojnë në kohë reale se sa të kërcënuar janë nga rreziku individual për retinopati diabetike, duke u bazuar në profilin e tyre të rrezikut dhe ndihmon për të ndjekur progresin e sëmundjes me kalimin e kohës. Ai përfshin udhëzime të hollësishme dhe informacion të dobishëm mbi diabetin, retinopatinë diabetike dhe kujdesin personal, duke i ndihmuar pacientët për të kuptuar më mirë gjendjen e tyre dhe të kujdesen vetë për një jetë më cilësore.

Aplikacioni Retina Risk mundëson personat me diabet të përfshihen vetë në vendime lidhur me kujdesin ndaj shëndetit të tyre. Ai ndihmon vetë-menaxhimin e pacientit duke sinjalizuar rëndësinë e ekzaminimeve të rregullta të syve dhe nevojën për të kërkuar ndihmë mjekësore në kohë. Ky aplikacion është i lehtë për t'u përdorur, efektiv dhe efikas si mjet për të kuptuar se si përmirësimi i faktorëve të ndryshëm të riskut (psh. glukozja në gjak, HbA1c, tensioni) mundet të ulin ndjeshëm rrezikun e mundshëm e humbjes së shikimit të syve diabetikë dhe atë të ndërhyrjeve të kushtueshme. Ajo i motivon personat me diabet të ndërhyrë dhe të bëhen pacientë më të informuar.

Algoritmi themelor i aplikacionit Retina Risk App bazohet në hulumtime të gjera ndërkombëtare mbi faktorët e rrezikut që ndikojnë në përparimin e retinopatisë diabetike, të tillë si kohëzgjatja e diabetit, gjinia, presioni i gjakut dhe niveli i glukozës në gjak (HbA1c). Ky aplikacion u testua klinikisht në 20,000 persona me diabet dhe rezultatet janë botuar në disa revista mjekësore të mirënjohura.

Aplikacioni Retina Risk nuk ruan të dhëna të lidhura me shëndetin. Vlerat klinike mund të vendosen manualisht, por aty ku disponohen të dhëna elektronike shëndetësore, qasja lehtësohet përmes platformës *digi.me*.

Aplikacioni Retina Risk është pa pagesë dhe qëllimi ynë është që ta çojmë atë në duart e sa më shumë personave me diabet të jetë e mundur në mbarë botën. Aplikacioni Retina Risk mund të shkarkohet duke përdorur linqet e mëposhtme:

Google Play - <https://play.google.com/store/apps/details?id=com.retinarisk>

Apple Store - <https://itunes.apple.com/us/app/retinarisk/id1370996145?mt=8>

Informacion më i plotë mund të gjendet në website - www.retinarisk.com

